



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Ilir Halili	11.12.2019	20.12.2019
Njomze Blakaj		

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 02.12.2019, OE “PRIMA INVEST shpk”, ka parashtruar ankesë me nr: 866/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “GM ARCHITECTURE” kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “ Hartimi I projektit ideor dhe projektit zbatues per qendren kulturore ne Pagarushe te Malisheves” me nr. të prokurimit: 207-18-8348-4-3-2, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Kulture, Rinis dhe Sportit MKRS.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur,lloji i kontratës: vlere e parashikuar e kontratës: 30,000€.

Ankesa është e përsëritur, e lidhur me ankesën dhe vendimin e OSHP-së, më Nr.595/19 i dt: 23.10.2019.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2.PRETENDIMET ANKIMORE

Për secilin pretendim, çështjet e mëposhtme nga ankesa duhet të përmbledhen:

- Neni 7 I LPP-se – Barazi ne trajtim / Jo diskriminim
- Neni 59 I LP-se – Ekzaminimi, vleresimi dhe krahasimi I tendereve
- Neni 60 I LPP-se – Kriteret per dhenien e Kontrates
- Neni 41 I RrUOPP-se
- Dosja e Konkursit te Projektimit - Pika 9.1 dhe 9.2 se te dhenave te tenderit (FDT) Kerkesat mbi mundesite teknike dhe profesionale
- KODI NR, .06/L-074 – Kodi Penail i Republikes se Kosoves

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Prima Invest shpk” - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Hartimi I projektit ideor dhe projektit zbatues per qendren kulturore ne Pagarushe te Malisheves”, me numër të prokurimit: 207-18-8344-4-3-2, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MKRS.

- Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik\
- Vendimi nr.595 i datës 23.10.2019 i OSHP-se

Ne si ndërmarrje projektuese kemi marrë pjesë në konkursin e Projektimit për "HARTIMIN E PROJEKTIT IDEOR DHE PROJEKTIT ZBATUES PËR QENDRËN KUITURORE NË PAGARUSHË TË MALISHEVËS" të shpallur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Pas vendimit nr.595 të datës 23.10.2019 të OSHP-së për kthimin në rivlerësim të këtij konkursi të projektimit, AK me datë 21.11.2019 përmes platformës së E-Prokurimit të Kosovës shpall vendimin e vet, ku përsëri e shpallë fitues OE GM Architecture. Pas marrjes vendimit të AK-së ne si OE pjesëmarrës në këtë aktivitet prokurimi bëjmë kërkesë për qasje në dokumente publike. Pas qasjes në Raportin e Ri-vlerësimit e vërejmë qartë se AK nuk ka respektuar dispozitat ligjore të Dosjes së Konkursit të Projektimit, Ligjin për Prokurim Publik, Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ të Prokurimit Publik dhe vendimin nr.595 të datës 23.10.2019 të OSHP-së.

Në bazë të nenit 108/A - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, pika 5 e Ligjit të Prokurimit Publik, bazuar në të gjeturat konkrete të mosrespektimit të bazës ligjore të lartpërmendur, ne si OE kemi bërë Kërkesës për Rishqyrtim. AK megjithë shkeljet ligjore që i ka bërë në Raportin e vet të rivlerësimit, refuzon kërkesën tonë për rishqyrtim.

Në vazhdim, po i prezentojmë të plota argumentet tona, të cilat i kemi prezentuar edhe në Kërkesën tonë për rishqyrtim, që dëshmojnë mospërmbylljen e pikës 9.1 dhe 9.2 të Fletës së të dhënave të tenderit (FDT) të Kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të Dosjes së Konkursit të Projektimit, mosrespektimin e Ligjit për Prokurim Publik, Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik dhe mosrespektimin e kërkesave të vendimit nr.595 të datës 23.10.2019 të OSHP-së.

1. Kërkesa e 1-rë e vendimit nr.595 të datës 23.10.2019 të OSHP-së, e cila nuk është respektuar nga AK-ja

Gjatë rivlerësimit AK të vërtetojë me saktësipretendimin ankimor se OE i rekomanduar për kontratë një projekt të lagjes së shtëpive e ka prezentuar rrejtshëm si Plan Rregullues. Pra, të vërtetohet se a është hartuar Plan Rregullues (ashtu siç është kërkuar nga AK-ja të dëshmohej përmes kontratës dhe referencës).

Përgjigja e AK-se në Raportin e rivlerësimit dhe në përgjigjen në kërkesën tonë për rishqyrtim lidhur me pikën e 1-rë të vendimit të OSHP-së

AK në asnjë pjesë të vendimit të saj (Raportit të rivlerësimit dhe përgjigjes në kërkesën tonë për rishqyrtim) nuk merret me vërtetimin me saktësi të pretendimit tonë ankimor se OE i rekomanduar për kontratë një projekt të lagjes së shtëpive e ka prezentuar rrejtshëm si plan rregullues. Është me rëndësi të potencohet fakti se vërtetimi me saktësi i këtij pretendimi tonë ankimor ka qenë i lehtë të bëhet, për arsye se AK-ja ka pasur qasje në listën e kontratave dhe referencave të këtij OE ku është prezentuar rrejtshëm si plan rregullues projekti i lagjes së shtëpive, duke shkelur kështu nenin 415 - Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik & Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "Prima Invest shpk" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Hartimi i projektit ideor dhe projektit zbatues për qendrën kulturore në Pagarushë të Malisheves", me numër të prokurimit: 207-18-8344-4-3-2, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - MKRS.

Ndërsa, lidhur me kërkesën e OSHP-së ku kërkohet të vërtetohet se a është hartuar Plan Rregullues (ashtu siç është kërkuar nga AK-ja të dëshmohet përmes kontrates dhe referencës), AK-ja as në Raportin e Rivlerësimit, e as në përgjigjen në kërkesën tonë për rishqyrtim nuk përgjigjet drejtpërdrejtë dhe me saktësi konform kërkesës së OSHP-së e cila pyet qartë: a është hartuar plan rregullues (ashtu siç është kërkuar nga AK-ja të dëshmohet përmes kontrates dhe referencës). AK-ja lidhur me këtë kërkesë të OSHP-së bën shmangie totale nga përgjigja me saktësi në këtë kërkesë dhe pa ndonjë argument të saktë ligjor konstaton se "kontrata dhe referenca është EKUIVALENT me kërkesën e dosjes së tenderit dhe me rekomandimet e OSHP-së".

Pra, në këtë rast shihet qartë se AK-nuk konstaton se është hartuar plan rregullues (ashtu siç është kërkuar nga AK-ja të dëshmohet përmes kontratës dhe referencës), por pa argumente të bazuara ligjërisht thotë që kontrata dhe referenca është ekuivalente me kërkesën e dosjes së tenderit dhe me rekomandimet e OSHP-së, gjë që nuk ka qenë as kërkesë e Dosjes së Konkursit të Projektimit, e as kërkesë e vendimit të OSHP-së të konstatohet ndonjë lloj e ekuivalencës apo e ngjashmërisë. Në Dosjen e konkursit të projektimit **kërkohen saktësisht kontrata dhe referenca për PLANE**

RREGULLUESE e jo ekuivalente apo të ngjashme me plane rregulluese. Po ashtu në vendimin nr.595/19 të OSHP-së kërkohet **të saktësohet se a është hartuar Plan Rregullues** (ashtu siç është kërkuar nga AK-ja të dëshmohet përmes kontratës dhe referencës) e jo ekuivalent apo i ngjashëm me plane rregulluese, por është kërkuar saktësisht kontrata dhe referenca për plane rregulluese.

Është me rëndësi të theksohet se edhe nëse kërkesa e AK-së në Dosjen e Konkursit të Projektimit të ishte "kontrata dhe referenca për Plane rregulluese apo të ngjashme (ekuivalente)" kjo kërkesë nuk do të mund të përmbushej nga OE GM Architecture për arsye se **ZGJIDHJA URBANE sipas bazës ligjore në fuqi dhe sipas interpretimit të MMPH-së (datë 13.09.2019) nuk është kategori e dokumenteve të planifikimit hapësinor, pra nuk është ekuivalente apo e ngjashme me Planin Rregullues.**

Si konstatim mund të thuhet se AK gjatë rivlerësimit nuk ka arritur të dëshmojë se OE i rekomanduar për kontratë ka hartuar Plan Rregullues. Me këtë rast, konstatohet qartë se nuk janë plotësuar Kërkesat mbi mundësitë tenike/profesionale të kërkuar nga AK në Dosjen e Konkursit të Projektimit dhe nuk është respektuar vendimi nr.595/19 i datës 23.10.2019 i OSHP-së.

2. Kërkesa e 2-të e vendimit nr.595 të datës 23.10.2019 të OSHP-së, e cila nuk është respektuar nga AK-ja

AI< duhet që konform nenit 72 të LPP-së të vërtetojë 2 dëshmitë e ofruara nga OE ankues: dëshminë e parë: sa i përket vendimit 05 nr.350-271083 i datës 25.01.2017 i lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës për caktimin e Kushteve Ndërtimore; si dhe dëshminë e dytë lidhur me vendimin 05 nr.351/02-0247279/17 të datës 06.05.2019 lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës për Lejimin e Ndërtimit. Paneli Shqyrtues konstaton se **AK duhet të vërtetojë se përmes këtyre 2 vendimeve a është hartuar Plan Rregullues apo është hartuar zgjidhje urbane e projekteve të**

shtëpive individuale.

Përgjigja e AK-se ne Raportin e rivleresimit dhe në përgjigjen në kërkesën tonë për rishqyrtim lidhur me pikën e 2-të të vendimit të OSHP-së

AK-ja thotë që bazuar në vendimin e OSHP-së nr.595/19 të datës 23.10.2019 dhe konform nenit 72 të LPP-së i është drejtuar OE GM Architecture për sqarime shitesë dhe ka marrë përgjigje në këto sqarime shitesë. AK thotë që sqarimet janë konform pyetjeve të parashtruara.

Është me rëndësi të potencohet se OE GM Architecture në përgjigjet e veta askund nuk ka arritur të konstatojë se në baze të 2 vendimeve të Drejtorisë së Urbanizmit të Komunës së Prishtinës është hartuar Plan Rregullues (ashtu siç është kërkuar nga AK-ja të dëshmohet përmes kontratës dhe referencës). Argumentet tona tjera të detajuara që kontestojnë ligjërisht përgjigjen e OE të rekomanduar për kontratë i kemi prezentuar në Kërkesën për Rishqyrtim (që është bashkëngjitur kësaj Ankese).

Më tej, në Raportin e vlerësimit dhe në përgjigjen në kërkesën tonë për rishqyrtim AK-ja duke mos dhënë përgjigje në kërkesën e OSHP-së lidhur me 2 dëshmitë e vendimeve të Komunes së Prishtinës thotë: *"....shihet qartë që ZGJIDHJA URBANE e cila theksohet në këtë rast përmban TË GJITHA kërkesat, detaje apo kushtet të cilat aplikohen edhe në rastet e hartimit të një Plarti Rregullues të Hollësishëm për një zonë të caktuar. E për të cilën ne kemi konsideruar dhe konsiderojmë se dallimi në këtë rast ka të bëjë thjeshtë me natyrën administrative të emërimit të dokumentit i cili në rastin kur quhet Plan Rregullues i Hollësishëm duhet të jetë dokument i aprovuar nga instancat e pushtetit lokal. Ndërsa, në rastin e dytë ai emërtohet duke u bazuar në kriteret profesionale, pra përdonjë dallim tjetër. Megjithatë, një ZGJIDHJE URBANE e përmasave të tilla për një zonë mbi 14 ha, që është ofruar ngapala plotëson kriteret e eksperiencës së dokumentuar, sepse kjo zgjidhje përmban përcaktimin e elementeve urbane me shumë planifikimit urbane, në harmoni me Planin Zhvillimor Komunal".*

Pra, siç dëshmohet edhe nga Raporti i Rivlerësimit i AK-së, po ashtu edhe nga Përgjigja e AK-së në kërkesën tonë për rishqyrtim, AK duke mos potenciuar askund 2 vendimet e Komunës së Prishtinës për këtë projekt të lagjes së shtëpive individuale, AK vetë konform kërkesës së vendimit nr.595/19 të datës 23.10.2019 të OSHP-së vërteton se është hartuar ZGJIDHJE URBANE e JO PLAN RREGULLUES (ashtu siç është kërkuar nga AK-ja që hartimi i planit rregullues të dëshmohet përmes kontratës dhe referencës). Se është hartuar zgjidhje urbane është e dëshmuar edhe në vendimin 05 nr.350-271083 të datës 25.01.2017 i lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës për caktimin e Kushteve Ndërtimore, ku teksualisht shkruan që është hartuar ZGJIDHJE URBANE,

Ndërsa, se a është i njëjtë Plani Rregullues me Zgjidhjen Urbane është vërtetuar me saktësi nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në interpretimin e saj (datë 13.09.2019) ku konstatohet se Plani Rregullues është kategori e dokumenteve të planifikimit hapësinor, ndërsa Zgjidhja Urbane dhe Projekti Urbanistik NUK JANË (nuk ekzistojnë) si kategori e dokumenteve të planifikimit hapësinor.

Pra, bazuar në këto argumente ligjore dëshmohet se AK-ja gjatë procedurës së

rivlerësimi nuk ka respektuar dispozitat ligjore të Dosjes së Konkursit të Projektimit, të LPP-së dhe RrUOPP-së dhe vendimin nr.595/19 të datës 23.10.2019 të OSHP-së për arsye se:

- edhe pse ka konstatuar se është hartuar ZGJTDHJE URBANE e jo Plan Rregullies, është munduar ta tejkalojë dhe madje edhe ta ndryshojë kërkesën e Dosjes së Konkursit të Projektimit për kontrata dhe referenca për plane rregulluese të hartuara, duke dhënë konstatime të pabazuara për përmbushjen e kësaj kërkesë të Dosjes së Konkursit të Projektimit dhe në të njëjtën kohë duke u munduar që të modifikojë kërkesat e Dosjes së Konkursit të Projektimit duke thënë se ZGJTDHJA URBANE është ekuivalente me PLANET RREGULLUESE (edhe ngashmëria apo ekuivalenca me plane rregulluese nuk ekziston si kërkesë as në Dosjen e Konkursit të Projektimit e as në kërkesat e vendimit nr. 595/19 të datës 23.10.2019 të OSHP-së);

- vendimin e vet për rivlerësim të këtij aktiviteti të prokurimit AK e bazon në interpretime të lira të komisionit të rivlerësimit, interpretime këto të mbështetura vetëm në pohimet jokompetente dhe jo të bazuara ligjërisht të subjektit të kësaj çështjeje kontestuese - OE të rekomanduar për kontratë;

- AK sipas nenit 72 për sqarime shtesë lidhur me kërkesën e OSHP-së për vërtetimin me saktësi të 2 dëshmime, përkatësisht 2 vendimeve të Komunës së Prishtinës (vendimit 05 nr.350-271083 të datës 25.01.2017 i lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës për caktimin e Kushteve Ndërtimore; si dhe dëshminë e dytë lidhur me vendimin 05 nr.351/02-0247279/17 të datës 06.05.2019 lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës për Lejimin e Ndërtimit) se a është hartuar plan rregullues, ka qenë e obliguar që këtë vërtetim të fakteve ta bëjë duke u bazuar në këto 2 vendime dhe nëse e ka vlerësuar të nevojshme të marrë sqarime shtesë zyrtare nga vetë Komuna e Prishtinës për kërkesën e OSHP-së se përmes 2 vendimeve të Komunës së Prishtinës a është hartuar plan rregullues apo jo (edhe pse kjo gjë është e qartë vetëm po të lexohen këto 2 vendime të Komunës së Prishtinës dhe po ashtu kjo qartësohet edhe më shumë nga konfirmimi i Komunës së Prishtinës i datës 30 gusht 2019 ku konfirmohet se 'Komuna e Prishtinës nuk ka asnjë Plan Rregullues të miratuar me emrin "Hasan Prishtina" në Çagllavicë. Të gjitha planet rregulluese dhe zhvillimore janë të publikuara në ueb faqen e Komunës" (dëshmi kjo bashkëngjitur kësaj ankese); Me këto veprime, duke tentuar të tejkalojë, modifikojë e të interpretojë pa bazë ligjore kërkesat e Dosjes së Konkursit të Projektimit, ku kërkohen kontrata dhe referenca për plane rregulluese të hartuara, AK ka shkelur nenin 41 të RrUOPP-se ku thuhet: "Autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kritere ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë procedurës së prokurimit. Kjo gjithashtu vlen, kur autoritetet kontraktuese ri-vlerësojnë procedurën e prokurimit në mënyrë që të korrigjojnë vendime të gabueshme dhe kur një ri-vlerësim bëhet si rezultat i një vendimi të OSHP-së përfshirë një urdhër për ri-vlerësim".

3. Kërkesa e 3-të e vendimit nr.595 të datës 23.10.2019 të OSHP-së, e cila nuk është respektuar nga AK-ja

AK duhet të konstatojë se Projekti i emërtuar si Zgjidhje Urbane apo si Projekti Urbanistik dhe Infrastruktura e Lagjes (ashtu siç është projekti i prezantuar nga OE i

rekomanduar për kontratë) a ekzistojnë si kategori e dokumenteve të planifikimit hapësinor.

Përgjigja e AK-se në Raportin e rivlerësimit dhe në përgjigjen në kërkesën tonë për rishqyrtim lidhur me pikën e 3-të të vendimit të OSHP-së

As AK, por as OE i rekomanduar për kontratë në asnjë rast nuk japin përgjigje në kërkesën e lartpërmendur të OSHP-se të prezantuar përmes vendimit nr.595/19 të datës 23.10.2019.

AK e ka pasur shumë të lehtë të përgjigjet në kërkesën e vendimit të OSHP-së për arsye se e ka pasur në dispozicion interpretimin e MMPH-së (datë 13.09.2019, bashkëgjatur kësaj ankese) ku thuhet qartësisht se **Zgjidhja Urbane dhe Projekti Urbanistiki lagjes NUK EKZISTOJNË si kategori e dokumenteve të planifikimit hapësinor.**

4. Kërkesa e 4-të e vendimit nr.595 të datës 23.10.2019 të OSHP-së, e cila nuk është respektuar nga AK-ja

Paneli shqyrtues i OSHP-së konstaton se gjatë rivlerësimit AK-ja duhet të ketë parasysh nenin 59 paragrafi 4 të LPP-së i cili thotë: *"Autoriteti Kontraktues do të konsiderojë një tender të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me TË GJITHA kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit"*

Arsyetimet e AK-se të prezentuara në Raportin e rivlerësimit dhe në përgjigjen në kërkesën tonë për rishqyrtim lidhur me pikën e 4-të të vendimit të OSHP-së

AK me arsyetimin e saj në Raportin e rivlerësimit dhe në përgjigjen e kërkesës sonë për rishqyrtim dëshmon se gjatë procesit të rivlerësimit **nuk ka respektuar nenin 59 paragrafin 4 të LPP-së për arsye se e ka konsideruar një OE të përgjegjshëm, edhe pse dokumentacioni i këtij operatori ekonomik NUK ISHTE në përputhshmëri me TË GJITHA kërkesat e parashtruara në njoftimin e konkursit të projektimit dhe në dosjen e konkursit të projektimit.**

Nga argumentet e mësipërme të prezentuara në këtë ankesë dhe në kërkesën tonë për rishqyrtim, dëshmohet qartësisht se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka përmbushur kërkesën e Dosjes së Konkursit të Projektimit, e prezentuar tek pika 9.1 dhe 9.2 e Fletës së të dhënave të tenderit (FDT) tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ku kërkohet që: *"Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka realizuar kontrata në lëmin e hartimit të projekteve të investimeve publike apo/dhe investimeve private, si dhe PLANEVE RREGULLUESE në vlerë 40,000.00 €"*. Dhe, për të dëshmuar këtë kontratë si dëshmi e kërkuar dokumentare kërkohet që *"të paraqiten dëshmitë: referenca për projekte dhe PLANEVE RREGULLUESE të hartuara në vlerën 40,000.00 euro (katërdhjetë mijë euro)"*

Bazuar në argumentet e lartpërmendura të cilat dëshmojnë se OE i rekomanduar për

kontratë është OE i përgjegjshëm ligjrisht, kërkojme nga OSHP që bazuar në kompetencat e saj ligjore përmes një URDHËRESE të detyrojë ligjrisht AK-në që duke e kthyer në rivlerësim këtë aktivitet prokurimi të shpallë fituesin e këtij aktiviteti prokurimi nga renditja e OE-ve të përgjegjshëm.

3. KRITERET PËR VLERËSIM

III.2.1 Kërkesat e përshtatshmërisë

1. Zotimin e OE se i plotëson kërkesat për të konkurruar sipas Ligjit 04/L-042, Neni 65,
2. Dëshminë nga gjykata ekonomike se OE nuk është i dënuar sipas nenit 65 të LPP apo ndaj OE nuk është ngritur ndonjë çështje gjyqësore,
3. Vertetim nga Administrata tatimore e vendit tuaj re themelimit se nuk jeni ne vonesë për pagesen e tatimeve së paku deri ne tremujorin e fundit.
4. Operatori ekonomik duhet te dëshmoi se i përmbush “Kërkesat e përshtatshmërisë” Pika III 1.1.)2.a.b.c. dhe e.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Vërtetimet

5. Deklarata nën betim që tenderuesi i plotëson kërkesat për të konkurruar sipas Ligjit 04/L-042, Neni 65, e nënshkruar dhe vulosur,- OBLIGATIVE
6. Vërtetim nga gjykata ekonomike (jo me te vjetër se tre muaj) se OE nuk është i dënuar sipas nenit 65 të LPP për secilin partner të një grupi operatorësh ekonomik-*original ose i noterizuar për kompanin e cila propozohet për shpërblim të kontratës*
7. Një vërtetim i nënshkruar nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para dorëzimit të tenderit për secilin partner të një grupi operatorësh ekonomik-*ky dokument dorezohet nga tenderuesi para dhënies së kontrates*

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

1. OE duhet të dëshmojë se janë të regjistruar ne regjistrin profesional, komercial ne vendin e themelimit per veprimtarine perkatese.
2. OE duhet të dëshmojë se jane te regjistruar ne regjistrin fiskal

Dëshmia e kërkuar dokumentare

- 1.Certifikata e Regjistrimit të Biznesit **kopje**
- 2.Certifikata e nr. fiskal

III.2.3) Kapaciteti teknik dhe profesional

1. Të drejtë pjesëmarrje kanë të gjithë profesionistët e fushës së arkitektures
2. OE duhet të dëshmojë se ka realizuar kontrata në lëmin e hartimit të projekteve të investimeve publike apo private si dhe planeve rregulluese me vlere 40,000.00€

IV.2) Kriteret që do të Aplikohen ne vleresimin e projekteve

Nenkriteret

Per tu konsideruar nje zgjidhje arkitektonike si e pranueshme duhet te fitoj se paku 50 pike teknike.

Proporcioni ne mes te vleresimit teknik dhe cmimit do te jete 80%: 20%.

Pesha %

Kriteret , nen-kriteret dhe sistemi i cili do te perdoret per vleresimin e koncept projekteve jane:

Nen-kriteret pesha %:

1. Zgjidhja urbanistike 25%
 2. Zgjidhja arkitektonike arritja e fleksibilitetit te organizimit të hapësirave të qendres 25%
 3. Krijimi i identitetit bashkekohor dhe inovativ të qendres 50% dhe
- Piket totale per kriteret teknike :100**

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES (VENDIMI I AK-së)

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

Pergjigje ne pikat ankuese OE “Prima Invest”& “Prima Engineering”.

Autoriteti Kontraktues (AK) ka vepruar ne baze te Vendimit te OSHP-es me nr.595/19 te dates 23/10/2019dhe ne baze te Nenit 72 te LPP-se ku i eshte drejtuar per informata shtese OE “GM Architecture”shpk. OE me dta 08/11/2019 është përgjigjur me sqarimet ne pyetjet tona. Sqarimet janë konform pyetjeve te parashtruara.

Pra AK edhe njhere deshmon se OE”GM Architecture”shpk, kontratat dhe referencat e paraqitur ne oferte e tyre është ekuivalent me kërkesën e dosjes se tenderit dhe rekomandimeve te OSHP-es dhe pyetjes sone.

Bazuar ne te dhenat e dokumentuara qe jane krahasuar dhe bazen ligjore ne fuqi.shihet qarte se zgjidhja urbane e cila theksohet ne kete rast, permban te gjitha kerkesat.detaje apo kushtet te cilat aplikohen edhe ne rastet e hartimit te nje Plan Rregullues i Hollesishem per nje zone te caktuar.E per te ccilen ne kemi konsideruar ahe konsideroime se dallimi ne kete rast ka te beje thjeshte vetem me

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Prima Invest shpk” - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Hartimi I projektit ideor dhe projektit zbatues per qendren kulturore ne Pagarushe te Malisheves”, me numër të prokurimit: 207-18-8344-4-3-2, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MKRS.

natyren administrative te emerimit te dokumentit i cili ne rastin kur quhet Plan Rregullues i Hollesishem, duhet te jete dokument i aprovuar ne instancat e pushtetit lokal. ndersa ne rastin e dyte ,ai emerohet duke u bazuar ne kriteret profesionale ,pra pa ndonje dallim tjetesr. Megjithate nje zgjidhje urbane e permasave te tiila per nje zone mbi 14ha, qe eshte ofruar nga pala, ploteson kriteret e eksperiences se dokumentuar sepse kjo zgjidhje permban percaktimin e elementeve urbane me shume planifikimit urbane ne harmoni me Planin Zhvillimor Komunal.

AK rithekson se kerkesat e pershtatshmerise te vendosura ne nje procedure prokurimi kane per qellim te dokumentojne nje nivel te ekspertizes permeses deshmive te eksperiences ne fushen e tille te sherbimeve dhe ne raste kur kjo permbajtje e ekspertizes, arrihet te deshmohet me dokumente te njejta per nga permbajtja ,porte ndryshme nga forma dhe poashtu nese nuk kufizohen shprehimisht me depozita perkatese me vetem nje lloj te dokumentit, atehere, kerkesat e AK-se mund te quhen te plotesuara dhe te dokumentuara.

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Vendimi i OSHP-se në 595/19 date 23.10.2019 kerkese per rivleresim se a eshte hartuar plan rregullues apo jo.

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Pretendimi nr.1

OE i shpallur fitues nuk ka paraqitur dokument te rrejshem siç thuhet ne Ankesen e operatorit "Prima invest", sepse ai vet e ka quajtur si "Punimi i projektit Urbanistik dhe Parcelimi për lagjen e banimit Hasan Prishtina në Çagllavicë" se bashku me reference, OE ka paraqitur qarte nje projekt te zgjidhjes urbane te punuar nga kompania me te cilen deshmohet se ka pervoje ne projekte te ngjajshme te kerkuara sipas FDT -se. Do te ishte jo profesionale nese deklarojme se zgjidhja urbane e prezentuar nuk ka te beje asgje me plane rregulluese dhe nuk eshte pjese e planeve rregulluese kur dihet se: sipas Ligjit për Planifikimin Hapësinor, Neni 15

"Me plane rregulluese urbane caktohen kushtet për rregullimin e hapësirës si dhe rregullat e lokacionit të objekteve dhe ngastrat tokësore urbane. Planet rregulluese urbane do të definojnë zonat e ndërtimit dhe do të përfshijnë linjat e rregullimit, linjat e ndërtimit, normat teknike urbanistike dhe kushtet tjera lidhur me lokacionin e ndërtesave dhe ndërtimet tjera në ngastrat tokësore urbane".

Po ashtu "LIGJI Nr. 03/L-106 PER NDRYSHIMIN E LIGJIT PER PLANIFIKIM HAPSINOR Nr. 2003-14" ne Neni 2 e definon qartë se cfar nënkuptohet me termin "Plan Urbanistik".

Neni 2 i ligjit ne fjalë: "*Plan Urbanistik*" nënkupton *Plani Zhvillimor Urban dhe Planet Rregulluese Urbane*"

Shihet qarte qe ky dokument i prezentuar nga OE permban te gjitha informatat dhe kerkesat te cilat aplikohen edhe ne planet rregulluese.

Duke u bazuar ne kete une si ekspert teknik konstatoj qe ky pretendim i operatorit ekonomik eshte i pabazuar.

Pretendimi nr.2

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "Prima Invest shpk" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Hartimi I projektit ideor dhe projektit zbatues per qendren kulturore ne Pagarushe te Malisheves", me numër të prokurimit: 207-18-8344-4-3-2, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MKRS.

AK ka dhënë përgjigje se zgjidhja urbane e OE te rekomanduar dhe se “kontrata dhe referenca është EKVIVALENT me kërkesën e dosjes së tenderit”, dhe vlerësojmë se është e pranueshme referenca e tillë dhe është ekuivalente me referencën e planeve rregulluese të kërkuar në FDT.

Duke u bazuar në këtë unë si ekspert teknik konstatoj që ky pretendim i operatorit ekonomik është i pabazuar.

Pretendimi nr.3

Duhet të rikujtojmë se jemi duke bërë vlerësimin e një projekti për qendër kulturore dhe se komisionet e AK-së e kanë parë të arsyeshme që për këtë lloj të punëve OE ka dëshmuar qartë një listë me projekte të natyrës së ngjajshme, dhe nëse AK do të dëshmojë se zgjidhja urbane e prezentuar është pjesë e planeve rregulluese për këtë lloj natyre të punëve është kërkesë e panevojshme/jo relevante e OE ankues të kërkojë informacione për kategorizim të dokumenteve të planifikimit hapësiror.

Duke u bazuar në këtë unë si ekspert teknik konstatoj që ky pretendim i operatorit ekonomik është i pabazuar.

Pretendimi nr.4

Nëse “Punimi i projektit Urbanistik dhe Parcelimi për lagjen e banimit Hasan Prishtina në Çagllavicë” e prezentuar dëshmon se operatori ekonomik ka përvorje në këtë natyrë të punëve dhe nëse së bashku me referencat tjera ka dëshmuar se ka realizuar kontratë në lëmin e hartimit të projekteve të investimeve publike apo private si dhe planeve rregulluese me vlerë 40,000.00€ konsiderohet si e mjaftueshme për një objekt të Qendrës Kulturore dhe është e pakuptimtë të refuzohet oferta me vetmin arsyetim se dokumenti nuk është emërtuar si “Plan rregullues”.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura eksperti shqyrtues/teknik i propozon paneli shqyrtues që të refuzohet e pabazuar ankesa e OE ankues, ndërsa të të vërtetohet vendimi i AK-së njoftimi për dhënie të kontratës.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – MKRS.
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues - Prima invest shpk